



UNIVERSITETI “ALEKSANDER XHUVANI”

REKTORATI

Njofitim

**“Për procedurën e përjashtimit nga tarifa e shkollimit
për vitin akademik 2013-2014 në UE”**

Në mbështetje të Ligjit 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet, VKM Nr. 565, datë 27.06.2013, VKM Nr. 674, datë 07.08.2013, VKM Nr. 743 dhe VKM Nr. 744, datë 5.09.2013,

Njoftojmë:

Studentët që studiojnë në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” dhe vijnë nga shtresat sociale e mëposhtme:

1. Personat që nuk shikojnë / personat që nuk dëgjojnë.
2. Invalidët e punës dhe fëmijët e tyre.
3. Invalid. (*Për këtë kriter aplikojnë vetëm studentët që ndjekin studimet në programet “Bachelor” me kohë të plotë dhe studentët e vitit I që ndjekin studimet në programet “Master” me kohë të plotë.*
4. Invalidë paraplegjikë / tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre.
5. Fëmijët që gëzojnë statusin ligjor të jetimit .
6. Studentë të cilit njëri nga prindërit i është ndarë nga jeta dhe familja e tij përfiton ndihmë ekonomike nga njësitë e qeverisjes vendore (Komunë /Bashki) dhe vjen nga “familje në nevojë”.
7. Fëmijë romë / Ballkan – Egjiptianë.
8. Fëmijë nga prindër të dënuar politikë me heqje lirie.
9. Fëmijë të policëve e të ushtarakëve të forcave të armatosura të rënë ose plagosur për shkak të detyrës.
10. Të prekur nga sëmundja HIV-AIDS.
11. Studenti që ka mbaruar vitin akademik pararendës me të gjitha notat dhjeta. (*Për këtë kriter aplikojnë vetëm studentët që ndjekin studimet në programet “Bachelor “ me kohë të plotë).*

Të tërheqin formularin “PRAKTIKË PËR PËRJASHTIM TË PJESSHËM OSE TË PLOTË NGA DETYRIMI PËR PAGESËN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT” pranë rektoratit – protokollit ose në web -site: www.uni-el.edu.al rubrika Informacione/njofitime.

Dokumentacioni i përgatitur sipas formularit përkatës të dorëzohet nga vetë studenti në Rektorat –protokollit, nga data **07.10.2013 – 31.10.2013.**

Pas këtij afati nuk pranohen dhe shqyrtohen aplikime për përjashtim nga tarifa e shkollimit.